



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 49 datë 18.04.2025

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "THE ANIMAL-
ARMADILLO 3.0", GODINË ME BANESA KOLEKTIVE DHE HAPËSIRA
SHËRBIMI 2-3-4-5-6 KATE MBI TOKË DHE 2 KATE NËNTOKË, ME
VENDNDODHJE NË MJULL BATHORE-SAUK, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive "ABV-Konstruksion" sh.p.k. dhe "Premium Continuity Construction" sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "The Animal -Armadillo 3.0", Godinë me banesa kolektive dhe hapësira shërbimi 2-3-4-5-6 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë, me vendndodhje në Mjull Bathore-Sauk, Bashkia Tiranë, me subjekte zhvilluese shoqërinë "ABV-Konstruksion" sh.p.k., dhe shoqërinë "Premium Continuity Construction" sh.p.k.,
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuarit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTORI AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
Adelajda Roka



Nënshkruar më datë 13/03 2026